

RREGULLORE NR. 1999/20

UNMIK/RREG/1999/20

15 nëntor 1999

PËR AUTORITETIN BANKAR DHE TË PAGESAVE NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të forcimit të ekonomisë në Kosovë duke ofruar një sistem efikas pagesash dhe një sistem bankar të shëndoshë me themelimin e Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës,

Shpall sa vijon:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

STATUSI I AUTORITETIT BANKAR DHE TË PAGESAVE TË KOSOVËS

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (më tej i quajtur “BPK”) është një person juridik publik i vaçantë.

Neni 2

PËRKUFIZIME

Termat e përdorur kudo në këtë rregullore kanë kuptimet vijuese:

“bankë” nënkupton një person juridik të angazhuar në veprimtarinë e pranimit të depozitave në Kosovë dhe përdorimin e këtyre fondeve plotësisht ose pjesërisht për dhënien e kredive ose investimeve për llogari dhe me rrezik në emër të personave që kryejnë këtë aktivitet;

“kredi” do të thotë çdo angazhim direkt apo indirekt për dhënien e një shume parash në këmbim të të drejtës së kthimit të shumës së dhënë dhe të papaguar dhe të pagesës së interesit dhe detyrimeve të tjera mbi atë shumë, çdo shtyrje të afatit të pagesës së borxhit, çdo garanci e lëshuar për pagesën e një borxhi dhe çdo angazhim rreth fitimit të të drejtës së pagimit të një shume të hollash; termi “kredi” nuk përfshin depozitat bankare dhe blerjen e letrave me vlerë në tregun dytësor;

”letër me vlerë” do të thotë çdo instrument i arritjes së marrëveshjes për pagim të borxhit dhe çdo lloj instrumenti tjetër ekuivalent me këtë instrument të pagimit të borxhit, si në formë të certifikatës ashtu edhe të regjistrimit;

“institucion financiar” do të thotë një bankë ose person tjetër juridik që është i përfshirë në veprimtarinë e dhënies së kredive ose investimeve për llogari dhe me rrezik në emër të personit që kryen këtë aktivitet;

“direktiva” do të thotë rekomandime të padetyrueshme ose deklarata të politikës të nxjerra nga BPK për informimin e bankave dhe palëve të tjera të interesuara për veprimtaritë e BPK-së;

“standarde ndërkombëtare të kontabilitetit” do të thotë standardet më të fundit ndërkombëtare të kontabilitetit të nxjerra nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit;

“urdhëresë” do të thotë një direktivë e detyrueshme e nxjerrë nga BPK-ja për zbatimin e kësaj rregulloreje;

“tarifa të arsyeshme” do të thotë tarifat që mbulojnë kostot direkte ose indirekte të BPK-së për shërbimin ose shërbimet e ofruara për të cilat merret tarifa; dhe

“rregull” do të thotë një direktivë e detyrueshme e nxjerrë nga BPK-ja për zbatimin e kësaj rregulloreje për gjithë bankat dhe institucionet financiare.

Neni 3

MUNDËSITË E BPK-së

3.1 BPK-ja ka mundësi për të:

(a) nënshkruar kontrata; dhe

- (b) për qëllimet e aktivitetit të saj të blejë, të mbajë dhe të shesë pasuri si të tundshme ashtu edhe të patundshme.

3.2 BPK-ja, në emër të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK-ut”), mund të përdorë dhe administrojë pronën e Bankës Kombëtare të Kosovës me qendër në rrugën “Marëshal Tito” në Prishtinë (tani e njohur si rruga “Nënë Terezë”), si dhe pronën e Shërbimit të Pagesave Publike të Kosovës me qendër në rrugën “Lenini” në Prishtinë.

Neni 4

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

4.1 BPK-ja ushtron të gjitha kompetencat e dhëna posaçërisht me këtë rregullore dhe me legjislacionin në fuqi dhe kompetencat e tilla që janë bindshëm të domosdoshme për zbatimin e kompetencave të dhëna.

4.2 BPK-ja gëzon mëvetësi administrative dhe të funksionimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore. Askush nuk duhet të kërkojë të ndikojë në mënyrë të parregullt mbi anëtarët e Bordit Drejtues të BPK-së ose mbi punonjësit në kryerjen e detyrave të tij/saj apo të ndërhyjë në aktivitetet e BPK-së.

Neni 5

OBJEKTIVAT KRYESORË

Objektivat kryesore të BPK-së janë:

- (a) të zhvillojë një sistem efikas dhe të sigurt për pagesat e brendshme dhe
- (b) të zhvillojë likuiditetin, aftësinë paguese si dhe funksionimin efikas të një sistemi bankar të bazuar në tregun e qëndrueshëm.

Neni 6

KOMPETENCAT E VEÇANTA

BPK-ja ka këto kompetenca të veçanta:

- (a) T'i rekomandojë udhëzime të politikës së përgjithshme Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për fusha që janë nën përgjegjësinë e saj, nën drejtimin e Zëvendëspërfaqësuesit Special për Rindërtim dhe Zhvillim Ekonomik;

- (b) Të formulojë dhe zbatojë masat për pagesat dhe rregullimin e sistemeve për transaksione në valutë të vendit dhe të huaj në Kosovë, si dhe t'i mbikëqyrë dhe rregullojë ato.
- (c) Të posedojë dhe të përdorë një apo më shumë sisteme pagesash;
- (d) Të veprojë si bankë për Autoritetin Qendror Fiskal dhe, kur i kërkohet, të japë këshilla financiare për të;
- (e) Të veprojë si agjent fiskal i Autoritetit Qendror Fiskal;
- (f) Të mbajë depozita në valutë të huaj për bankat, Autoritetin Qendror Fiskal dhe për agjenci të tjera;
- (g) Të sigurojë një furnizim të rregullt me bankënota dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para në dorë;
- (h) Të mbajë një vend për ruajtjen e sigurt të valutës dhe letrave me vlerë;
- (i) Të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë bankat;
- (j) Të mbikëqyrë dhe kontrollojë tregtarët e këmbimit valutor dhe
- (k) Të kryejë rregullisht analiza ekonomike dhe monetare të ekonomisë në Kosovë, të publikojë rezultatet e të paraqesë propozimet dhe masat që duhen marrë në bazë të këtyre analizave në Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara.

Neni 7

BASHKËPUNIMI ME ADMINISTRATËN E PËRKOHESHME CIVILE

7.1 BPK-ja bashkëpunon me UNMIK-un, Administratën e Përkohshme të KB në Kosovë dhe me agjencitë e UNMIK-ut për arritjen e objektivave të saj.

7.2 Herë pas here, me kërkesën e Autoritetit Qendror Fiskal dhe agjencive të tjera të Administratës të Përkohshme të KB në Kosovë, BPK-ja jep informacion të përgjithshme në lidhje me pagesat, çështjet bankare dhe financiare dhe herë pas here edhe BPK-ja kërkon prej tyre informacion në lidhje me çështjet makroekonomike dhe financiare.

Neni 8

BASHKËPUNIMI TEKNIK

8.1 BPK-ja mund të marrë pjesë në mbledhjet e këshillave dhe organizatave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me aspektet teknike të sistemeve të pagesave, mbikëqyrjen bankare dhe çështjeve të tjera që janë brenda kompetencave të saj.

8.2 BPK-ja mund të ofrojë shërbime bankare dhe të pagesave për qeveritë e vendeve të huaja, bankat e huaja dhe autoritetet e huaja monetare, si dhe për organizatat publike ndërkombëtare dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.

Neni 9

INFORMIMI PUBLIK

Rregullisht dhe në kohë të planifikuar, BPK-ja informon publikun dhe Autoritetin Qendror Fiskal për analizat e bëra rreth zhvillimeve të tregut makroekonomik dhe financiar, si dhe për informacionin statistikor përkatës.

Neni 10

ZYRAT E BPK-së

Zyra qendrore e BPK-së është vendosur në Prishtinë. BPK-ja mund të hapë degë, zyra koordinimi dhe agjenci në vende ose shtete që ajo e gjykon të nevojshme.

Neni 11

LLOGARITË

11.1 BPK-ja mund të hapë llogari në librat e saj vetëm në emër të Autoritetit Qendror Fiskal, të agjencive të tjera të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të bankave që veprojnë ligjërisht në Kosovë, të bankave të huaja, të institucioneve financiare ndërkombëtare publike dhe të organizatave donatore. BPK-ja nuk mund të hapë llogari në emër të personave fizikë dhe ndërmarrjeve.

11.2 Gjithë pasivet e llogarisë depozitë të BPK-së duhet të kenë aktivet korresponduese si parashikohet në nenin 48 më poshtë.

DISPOZITA FINANCIARE

Neni 12

KAPITALI

12.1 Kapitali i autorizuar i BPK-së është 5 milionë DM. Për pasojë, kapitali i llogarive Rezerva të Përgjithshme është i barabartë me pesë për qind të shumës totale të bilanceve kredi të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e BPK-së nga mbajtësit e llogarive të dhëna në bilancin e BPK-së në fund të çdo viti financiar. Kapitali mund të rritet me shuma të tilla dhe mund të përcaktohet nga BPK-ja dhe të miratohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Kapitali i BPK-së nuk është subjekt barre.

12.2 Asnjë pakësim kapitali nuk mund të ndodhë, përveç kur shpallet me rregullore nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

12.3 Sa here që:

- (a) në bilancin mujor të BPK-së vlera e aktiveve të saj bie nën shumën e pasiveve të saj dhe të kapitalit të saj total të autorizuar, ose
- (b) fitimi neto i BPK-së për një vit financiar është i pamjaftueshëm për rritjen e kapitalit dhe llogaritë Rezerva të Përgjithshme të BPK-së në një nivel të barabartë me pesë për qind të shumës totale të bilancit kredi të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e BPK-së nga mbajtësit e llogarisë të pasqyruara në bilancin e BPK-së në fund të atij viti financiar,

Autoriteti Qendror Fiskal, brenda një muaji pas botimit të atij bilanci, bën të gjitha përpjekjet, brenda burimeve që ka në dispozicion për të dhënë një kontribut kapitali për BPK-në në atë shumë apo shumat e nevojshme për mbulimin e defiçitit.

Neni 13

PËRCAKTIMI DHE AKORDIMI I TË ARDHURAVE

13.1 Llogaritja e fitimit neto apo e humbjes neto të BPK-së bëhet çdo vit sipas standardeve ndërkombtare të kontabilitetit.

13.2 Fitimi neto akordohet çdo vit në një llogari të Rezervës së Përgjithshme, derisa kapitali dhe llogaritë e Rezervës së Përgjithshme të barazohen me pesë për qind të shumës totale të bilanceve kredi të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e BPK-së nga mbajtësit e llogarive të pasqyruara në bilancin e BPK-së në fund të çdo viti financiar.

13.3 Të gjitha shumat e fitimit neto transferohen në Autoritetin Qendror Fiskal si të ardhura për buxhetin.

13.4 Nëse ka humbje neto, kjo do të mbulohet nga llogaria e Rezervës së Përgjithshme ose nga kapitali, sipas kësaj radhe.

Neni 14

BUXHETI VJETOR

Të gjitha shpenzimet materiale të propozuara të BPK-së paraqiten në buxhetin vjetor për t'u miratuar nga Bordi drejtues, dhe i dërgohet për informacion Autoritetit Qendror Fiskal.

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 15

ORGANIZIMI I BPK-së

BPK-ja ka Bordin drejtues, udhëheqjen dhe stafin e saj.

Neni 16

BORDI DREJTUES

16.1 Bordi drejtues harton politikat për veprimtaritë e BPK-së dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre politikave.

16.2 Stafi i BPK-së i raporton, jo më pak se dhjetë herë në vit, Bordit drejtues për ecurinë e veprimtarive dhe politikave të tij, për gjendjen e sistemit financiar, për gjendjen e parave, kapitalit dhe tregut valutor, duke përfshirë këtu të gjitha rrethanat dhe kushtet që kanë apo që pritet të kenë efekt të ndjeshëm në drejtimin ose veprimtaritë e BPK-së, ose në ecurinë e politikave të saj, ose në sistemin financiar, ose në tregjet e përmendura më sipër.

Neni 17

KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES

Bordi Drejtues ka kompetencat e mëposhtme:

- (a) Përcakton politikat për ekzekutimin e kompetencave të BPK-së të përshkruara në nenin 6 dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga udhëheqësi dhe stafi i saj;
- (b) Miraton të gjitha rregullat, urdhëresat dhe udhëzuesit e nxjerrë nga BPK-ja;
- (c) Miraton të gjitha raportet dhe rekomandimet që BPK-ja jep për Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë;
- (d) Jep rekomandime për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për pjesëmarrjen e BPK-së në konsultimet teknike me organizatat ndërkombëtare;
- (e) Miraton statutin dhe dokumente të tjera ligjore të BPK-së;
- (f) Përcakton organizimin e BPK-së;
- (g) Miraton emërimin e inspektorit të Përgjithshëm të BPK-së;
- (h) Krijon dhe mbyll zyrat e degëve dhe agjencitë e BPK-së;
- (i) Përcakton buxhetin e BPK-së, afatet dhe kushtet për punësimin e punonjësve, agjentëve dhe korrespondentëve të BPK-së;
- (j) Përcakton politikat kontabël të BPK-së dhe miraton raportet periodike e deklaratat financiare të BPK-së;
- (k) Vendos për borxhin në shuma të konsiderueshme të BPK-së, afatet dhe kushtet e këtij borxhi;
- (l) Përcakton kategoritë e aktiveve që janë të përshtatshme për investimin e burimeve financiare të BPK-së;
- (m) Miraton ose refuzon kërkesat e bankave për licenca dhe revokon licencat bankare.

Neni 18

PËRBËRJA E BORDIT DREJTUES

18.1 Bordi drejtues përbëhet nga shtatë persona të caktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm: Kryetari, Drejtori i Përgjithshëm, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankës, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për Pagesat dhe tre persona të tjerë (dy prej të cilëve caktohen nga UNMIK-u).

18.2 Anëtarët e Bordit drejtues duhet të jenë persona me figurë të pastër morale dhe me përvojë profesionale në çështje financiare dhe bankare.

18.3 Mandati i çdo anëtari të Bordit drejtues zgjat gjashtë vjet. Anëtarët e Bordit drejtues kanë të drejtë të riemërohen.

Neni 19

SHPËRBLIMI I ANËTAREVE TË BORDIT DREJTUES

Anëtarët e Bordit drejtues marrin shpërblim nga BPK-ja të ngjashëm me shpërblimin që marrin personat që mbajnë poste ekzekutive ose joekzekutive në bordet mbikëqyrëse dhe të udhëheqjes, sipas rastit, në bankat tregtare në rajon.

Neni 20

PAMUNDESIA PËR TË SHËRBYER NË BORDIN DREJTUES

Asnjë person nuk mund të jetë anëtar i Bordit drejtues nëse ai/ajo është i punësuar në ndonjë bankë që vepron në Kosovë dhe nëse është zotërues i pesë për qind ose më shumë të pjesëmarrjes në kapital të një banke.

Neni 21

DISKUALIFIKIMI DHE LARGIMI I ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES

21.1 Bordit drejtues mund të largojë çdo anëtar nga Bordi, e në rastet kur këtë veprim nuk bën vetë Bordi atë mund ta largojë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në qoftë se ai/ajo:

- (a) humb të drejtën për të qenë anëtar i Bordit drejtues në përputhje me nenin 20;
- (b) ka kryer një vepër penale e cila dënohet me burgim pa alternativën e dënimit me gjobë;
- (c) ka qenë debitor në një procedurë falimentimi ose paaftësie paguese;
- (d) për arsye të sjelljes personale jokorrekte është pezulluar ose është diskualifikuar nga një organ kompetent për ushtrimin e profesionit dhe
- (e) kur shumica e anëtarëve të Bordit drejtues mendojnë se ai është angazhuar në veprimtari të paligjshme ose në sjellje jokorrekte në vendin e punës.

21.2 Përveç dispozitave të nenit 21.1, çdo anëtar i Bordit drejtues mund të largohet nga Bordi prej vetë Bordit, ose nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në rastet kur Bordi nuk e ndërmer këtë veprim dhe kjo behet në bazë të mendimit dhe rekomandimit të shumicës së anëtarëve të Bordit drejtues nëse anëtari:

- (a) nuk është në gjendje të kryejë funksionet e këtij organi për shkak të paaftësisë fizike ose mendore që zgjat më shumë se dy muaj; apo
- (b) ka munguar në tri mbledhje radhazi të Bordit Drejtues pa arsye të justifikuar sipas mendimit të Bordit drejtues.

Neni 22

DORËHEQJA

Anëtarët e Bordit drejtues mund të japin dorëheqje duke njoftuar me shkrim të paktën një muaj më parë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 23

VENDET E LIRA NË BORDIN DREJTUES

Çdo vend i lirë në Bordin drejtues duhet të plotësohet me emërimin e një anëtari të ri të Bordit drejtues në përputhje me nenin 18.

Neni 24

MBLEDHJET E BORDIT DREJTUES

24.1 Mbledhjet e Bordit drejtues drejtohen nga kryetari i Bordit drejtues dhe, në mungesë të tij, nga një anëtar i Bordit drejtues.

24.2 Bordi Drejtues takohet sa herë që e kërkon veprimtaria e BPK-së, por jo më pak se një herë në muaj.

24.3 Mbledhjet e Bordit drejtues thirren nga Drejtori i përgjithshëm; mbledhjet mund të thirren edhe me kërkesën me shkrim të dy anëtarëve të Bordit drejtues.

24.4 Mbledhjet e Bordit drejtues thirren duke i informuar gjithë anëtarët e Bordit drejtues për kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes të paktën pesë ditë pune para datës së caktuar për mbledhje; në raste urgjente mbledhjet mund të thirren me njoftim në interval kohe më të shkurtër.

24.5 Çdo anëtar i Bordit drejtues ka një votë. Në rastet kur numri i votave është i njëjtë, vota e kryetarit është vendimtare.

24.6 Për kryerjen e aktiviteteve në çdo mbledhje të Bordit drejtues kërkohet një kuorum prej pesë anëtarësh të Bordit drejtues.

24.7 Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë rregullore, vendimet e Bordit drejtues miratohen me shumicë të thjeshtë të votave të pjesëmarrësve në mbledhje; megjithatë, statuti i BPK-së mund të lejojë mbajtjen e mbledhjeve dhe votimin me anë të telefonit dhe në raste të jashtëzakonshme me anë të teleksit të verifikuar ose me anë të mjeteve të tjera të verifikuara elektronike të telekomunikacionit.

24.8 Asnjë akt ose veprim i Bordit drejtues, subjekt i kërkesës për kuorum siç përcaktohet në nenin 24.6, nuk zhvleftësohet thjesht për arsye të ndonjë vendi apo vendeve bosh në Bordin drejtues.

24.9 Gjitha veprimet e kryera nga një person që vepron në mirëbesim si anëtar i Bordit drejtues, janë të vlefshme pavarësisht se më vonë mund të gjenden mangësi në emërimin, të drejtën apo kualifikimet për të qenë anëtar i tij.

Neni 25

PROCESVERBALET E MBLEDHJEVE TË BORDIT DREJTUES

25.1 Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit drejtues janë konfidenciale. Bordi drejtues mund të vendosë t'i botojë rezultatet e vendimeve të tij për çfarëdo çështje dhe ato vendime për çështje të politikave të përgjithshme i boton menjëherë.

25.2 Procesverbali i çdo mbledhjeje të Bordit drejtues nënshkruhet nga kryetari ose nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga sekretari i Bordit drejtues.

25.3 Sekretarin e Bordit drejtues e emëron Drejtori i përgjithshëm nga radhët e punonjësve me eksperiencë të BPK-së dhe ai merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit drejtues, mban shënime dhe kryen funksione të tjera të përcaktuara në statutin e BPK-së. Sekretari nuk është anëtar i Bordit drejtues.

Neni 26

ZBULIMI NGA ANËTARËT E BORDIT DREJTUES; BESNIKËRIA

26.1 Anëtarët e Bordit drejtues kohë pas kohe ia zbulojnë plotësisht Bordit drejtues interesat e rëndësishme financiare të cilat ata apo anëtarët e familjeve të tyre mund t'i posedojnë në mënyrë direkte apo indirekte; zbulimet i tilla bëhen në përputhje me udhëzimet e miratuara nga Bordi drejtues.

26.2 Në çdo rast kur çështjet që kanë të bëjnë me interesa të tilla shtrohen për diskutim në Bordin drejtues, anëtari i interesuar në fillim të diskutimit zbulon interesat e tij dhe nuk merr

pjesë në diskutimin dhe marrjen e vendimit për këtë çështje; megjithatë, prania e tij/saj llogaritet për qëllime të përbërjes së kuorumit.

26.3 Anëtarët e Bordit drejtues dhe punonjësit e BPK-së janë të detyruar të jenë besnikë ndaj BPK-së dhe klientëve të BPK-së për të mos i vënë interesat e tyre mbi interesat e BPK-së dhe të klientëve të tyre.

Neni 27

PËRBËRJA E UDHËHEQJES SË BPK-së

Udhëheqja e BPK-së përbëhet nga drejtori i përgjithshëm, zëvendës drejtori i përgjithshëm për mbikëqyrjen dhe rregullimin e Bankës dhe zëvendës drejtori i përgjithshëm për sistemet e pagesave.

Neni 28

SHËRBIMI I MËPASTAJMË

Ish-anëtarët e Bordit drejtues menjëherë pas largimit të tyre nga BPK-ja për një vit nuk mund të shërbejnë në detyra profesionale në ndonjë bankë në Kosovë.

Neni 29

DREJTIMI I BPK-së

29.1 Drejtori i përgjithshëm ushtron detyrën e Drejtorit ekzekutiv të BPK-së i ngarkuar me udhëheqjen e veprimtarisë së përditshme të BPK-së. Nëse drejtori i përgjithshëm mungon apo nuk mund të veprojë, atëherë në mungesë të tij zëvendës drejtori i përgjithshëm për mbikëqyrjen dhe rregullimin e Bankës ose zëvendës drejtori i përgjithshëm për sistemet e pagesave, kryen punët e shefit ekzekutiv të BPK-së.

29.2 Drejtori i përgjithshëm përgjigjet para Bordit drejtues për ekzekutimin e vendimeve të BPK-së si dhe për drejtimin dhe kontrollin e administrimit të veprimtarisë së BPK-së.

29.3 Të gjitha kompetencat që nuk janë posaçërisht të rezervuara për Bordin drejtues i jepen drejtorit të përgjithshëm. Drejtori i përgjithshëm, brenda kufijve të kompetencave të tij, ka mundësi të ndërmarrë të gjitha veprimet e kërkuara ose të këshillueshme për administrimin dhe punën e BPK-së, duke përfshirë pa kufizim nënshkrimin e kontratave në emër të BPK-së, emërimin e punonjësve, agjentëve dhe korrespondentëve të BPK-së dhe në përgjithësi përfaqëson BPK-në. Drejtori i përgjithshëm, me miratimin e Bordit drejtues, mund t'ia delegojë disa nga kompetencat e tij(saj) punonjësve të tjerë të BPK-së.

29.4 Zëvendësdrejtori i përgjithshëm për mbikëqyrjen dhe rregullimin e Bankës është përgjegjës para drejtorit të përgjithshëm. Pavarësisht nga neni 17, zëvendësdrejtori i përgjithshëm për mbikëqyrjen dhe rregullimin e Bankës ka kompetenca për ndërmarrjen e masave shtrënguese, duke përfshirë këtu edhe urdhërimin e çdo banke për të ndërmarrë masat për zgjidhjen e problemit, caktimin e një kujdestari për një bankë ose vendosjen e masave të dënimit të parapara në këtë rregullore, në legjislacionin në fuqi ose në rregulloret për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave.

29.5 Zëvendësdrejtori i përgjithshëm për sistemet e pagesave është përgjegjës para drejtorit të përgjithshëm.

Neni 30

KONTROLLORI I PËRGJITHSHEM I BPK-së

30.1 Kontrollori i përgjithshëm i BPK-së emërohet nga drejtori i përgjithshëm me miratimin e Bordit drejtues. Kontrollori i përgjithshëm duhet të jetë person i kualifikuar dhe legjitim për të shërbyer në Bord.

30.2 Kontrollori i përgjithshëm mund të japë dorëheqje duke ia dorëzuar drejtorit të përgjithshëm njoftimin me shkrim dy muaj përpara. Kontrollori i përgjithshëm largohet nga detyra vetëm me vendim të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm apo të Bordit drejtues, që mbështetet në një apo në më shumë arsye për largimin e specifikuar në nenin 21.

30.3 Detyrat e Kontrollorit të përgjithshëm përfshijnë:

- (a) Vlerësimin e cilësisë së administrimit ekzistues dhe administrimit të propozuar si dhe të sistemeve të kontrollit financiar;
- (b) Testimin e funksionimit të atyre sistemeve, saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit e të transaksioneve të kryera;
- (c) Testimin e funksionimit si duhet të kontrollove për ruajtjen e pasurisë së BPK-së dhe, kur është e përshtatshme, verifikimin e ekzistencës së pasurisë;
- (d) Testimin e përputhjes së aktivitetit të BPK-së me ligjet, rregulloret, direktivat administrative, rregullat, urdhresat dhe politikat drejtuese;
- (e) Rishikimin e përdorimit të drejtë dhe të efektshëm të burimeve të BPK-së dhe dhënien e rekomandimeve të duhura udhëheqësisë dhe
- (f) Kryerjen e shqyrtimeve të veçanta kur kërkohet nga udhëheqja dhe lidhjen me kontrollorët financiarë të BPK-së.

Neni 31

PERSONELI I BPK-së

31.1 Nëse Bordi drejtues nuk vendos ndryshe, BPK është i vetmi autoritet që mund të punësojë personelin e BPK.

31.2 Bordi drejtues miraton kriteret dhe kushtet e punësimit, të cilat duhet të përfshijnë dispozita për të mos lejuar konflikte interesi.

Neni 32

PUNONJËSIT, AGJENTËT DHE KORRESPONDENTËT E BPK-së

32.1 Drejtori i përgjithshëm emëron dhe ndërpret emërimin e punonjësve, agjentëve dhe korrespondentëve të BPK-së, brenda kufijve dhe në përputhje me kriteret dhe kushtet e përgjithshme të punësimit të miratuara nga Bordi drejtues.

32.2 Pagat, tarifat, rrogat apo shpërblimet a shtesat në të holla të paguara nga BPK-ja nuk llogariten në të ardhurat neto, në fitimin neto ose të ardhura të tjera të BPK-së.

Neni 33

KONFLIKTI I INTERESIT

33.1 Udhëheqja dhe kontrollori i përgjithshëm duhet t'ia përkushtojnë gjitha shërbimet e tyre profesionale BPK-së dhe nuk mund të kenë pozita të tjera zyrtare a punësimi, me ose pa shpërblim, përveç si kandidatë të BPK-së dhe për raste të aktiviteteve edukative dhe të komunitetit.

33.2 Asnjë anëtar i Bordit drejtues ose punonjës i BPK-së nuk guxon të pranojë dhurata apo kredi në emër të vetin ose në emër të ndonjë personi me të cilin ka lidhje familjare, lidhje biznesi apo financiare në qoftë se një pranim i tillë do të ndikonte apo do të linte përshtypjen e zvoglimit të përkushtimit të paanshëm ndaj detyrave të të tij/saj në BPK.

Neni 34

SEKRETI

34.1 Asnjë personi i cili shërben ose ka shërbyer si anëtar i Bordit drejtues, ose si punonjës apo kontrollor financiar, si agjent ose korrespondent i BPK-së nuk i lejohej që në mënyrë të paautorizuar, siç parasheh kjo rregullore, të arrijë deri te informatat, t'i zbulojë apo t'i botojë ato që nuk janë për publik, e të cilat ai i ka arritur gjatë kryerjes së detyrave të tij në BPK ose të lejojë përdorimin e informacion të tillë, për përfitime personale.

34.2 Pavarësisht nga neni 34.1, këta persona mund të bëjnë të nxjerrin informacion të materialeve jopublike jashtë BPK-së në përputhje me procedurat e përcaktuara nga BPK vetëm në rastet:

- (a) kur kjo bëhet në përputhje me pëlqimin e shprehur apo të nënkuptuar të personit me të cilin ka të bëjë informacioni;
- (b) e kryerjes së një detyre ndaj publikut për zbulimin e informacionit, duke përfshirë ndihmën për zbatimin e ligjit dhe me urdhër të një gjykate apo të ndonjë personi tjetër kompetent,
- (c) kur i jepet kontrollorëve financiarë të BPK-së;
- (d) kur i jepet organeve mbikëqyrëse të institucioneve financiare dhe stafit të institucioneve financiare publike ndërkombëtare për kryerjen e detyrave të tyre zyrtare; ose
- (e) kur interesi i vetë BPK-së në procedura ligjore kërkon zbulim të informacionit.

RAPORTET ME ENTITETET E ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME NË KOSOVË

Neni 35

BANKAR, KËSHILLTAR FINANCIAR, AGJENT FISKAL

35.1 BPK-ja vepron si bankar, si këshilltar dhe si agjent fiskal i Organit Qendror Fiskal dhe i entiteteve të tjera të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë me kusht që asnjë transaksion i kryer nga BPK-ja të mos jetë në shërbim të dhënies së kredive ose për përfitimin e ndonjë organi publik apo të personave të tjerë fizikë dhe juridikë.

35.2 BPK-ja ka për detyrë t'i japë këshilla Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, rreth çështjeve të rëndësishme bankare dhe financiare që kanë të bëjnë me objektivat e BPK-së, ose që janë brenda kompetencave të saj.

35.3 BPK-ja konsultohet me Organin Qendror Fiskal në rastet e përgatitjes së buxhetit.

Neni 36

DEPOZITAT DHE ARKA

BPK-ja mund të pranojë depozita në çfarëdo valute, nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, nga Organi Qëndror Fiskal, dhe nga entitetet e tjera të saj. Si depozitar, BPK-ja pranon dhe jep para, mban llogari për to dhe ofron shërbime të tjera financiare lidhur me

to. BPK-ja paguan në kufijtë e shumave të depozituara kundrejt urdhër-pagesave për llogaritë përkatëse. BPK-ja paguan interes për këto depozita sipas përqindjes së tregut, pas zbritjes së tarifave të arsyeshme.

Neni 37

FUNKSIONI I AGJENCISË FISKALE

BPK-ja, në përputhje me kriteret dhe kushtet për të cilat merret vesh me Organin Qendror Fiskal, mund të veprojë si agent fiskal për llogari të Organit Qendror Fiskal dhe të agjencive e instrumenteve të cilat mund t'i përcaktojë Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Neni 38

INFORMACIONI QË DUHET T'I JEPET BPK-së

Nga Organi Qendror Fiskal dhe nga entitetet e tjera të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë BPK-ja merr gjithë informacionin financiar e ekonomik dhe dokumentet që BPK-ja kërkon për kryerjen e funksioneve të saj.

RAPORTET ME BANKAT DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË PAGESAVE

Neni 39

PAGESAT, KLIRINGU DHE SHLYERJA E DETYRIMEVE

BPK-ja mund të organizojë, posedojë, operojë, mbikëqyrë dhe rregullojë sistemin e urdhër-pagesave për sistemimin dhe shlyerjen e pagesave ndërbankare në valutat e caktuara, me ose pa prerje ligjore për pagesa, duke përfshirë pagesat me anë të çekut dhe instrumenteve të tjera të pagesave, dhe përcakton këto procedura dhe nxjerr rregulla e urdhëresa që çmohen të përshtatshme lidhur me to.

Neni 40

LLOGARITË E BANKAVE NË LIBRAT E BPK-së

Çdo bankë që vepron në Kosovë dhe që dëshiron të marrë pjesë në sistemin e pagesave, me sistemimin dhe shlyerjen e detyrimeve, duhet të hapë dhe të mbajë një llogari në librat e BPK-së, sipas termave dhe kushteve të caktuara nga BPK-ja dhe duhet t'i japë menjëherë BPK-së informacionin e kërkuar lidhur me kushtet operacionale dhe financiare që BPK mund të përcaktojë me rregullore të saj.

Neni 41

RRJETI I INFORMACIONIT

BPK-ja mund të krijojë dhe mirëmbajë një rrjet informacioni për sistemin financiar të Kosovës.

Neni 42

MBIKËQYRJA DHE RREGULLIMI BANKAR

BPK-ja është i vetmi organ përgjegjës për licencimin (lejimin) e bankave në Kosovë dhe për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tyre dhe është e autorizuar:

- (a) Të nxjerrë rregulla, urdhresa dhe direktiva si dhe të ndërmarrë veprime të tilla si revokimin e licencave të bankave dhe vënien nën kontroll të bankave të falimentuara për të cilat konsiderohet e nevojshme ose e këshillueshme për ekzekutimin e kompetencave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga kjo rregullore dhe legjigjet tjera në fuqi;
- (b) Të inicojë kontrole të kryera nga nëpunësit e saj apo nga ndonjë person tjetër i kualifikuar, i caktuar për këtë qëllim në çdo bankë për të kontrolluar librat, regjistrimet, dokumentet dhe llogaritë e saj për t'u njohur me kushtet e veprimtarisë së saj dhe se a vepron ajo në përputhje me këtë rregullore, me rregullat, urdhresat dhe legjislacionin në fuqi për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave;
- (c) Të kërkojë nga drejtori, zyrtari apo nëpunësi i një banke t'i japë BPK-së informacionin e kërkuar me qëllim të mundësimit të BPK-së për mbikëqyrje dhe rregullim të bankave dhe
- (d) Të detyrojë një bankë të ndërmarrë veprime përmirësuese, të vendosë dënime të përcaktuara me këtë rregullore ose sipas ndonjë rregulle, urdhrese ose legjislacioni në fuqi për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave, nëse nga një bankë apo nga një ose më shumë zyrtarë a drejtorë të saj ka pasur shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, shkelje të ndonjë rregulle a urdhrese të legjislacionit në fuqi, ose një direktive të BPK-së, ose shkelje të ndonjë kushti ose kufizimi të bashkëngjitur ndonjë autorizimi ose miratimi të nxjerrë nga BPK-ja për ndonjë bankë, shkelje të ndonjë rregulli a urdhrese të nxjerrë nga BPK-ja.

Neni 43

RESPEKTIMI I RREGULLAVE DHE URDHRESAVE

43.1 Çdo bankë duhet të veprojë në përputhje me rregullat dhe urdhëresat e BPK-së lidhur me: llogaritë e bilancit, zërat jashtë bilancit, zërat në deklaratat e të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me raportet ndërmjet llogarive a zërave dhe ndalimeve, kufizimeve ose kushteve për lloje a forma specifike të kredive a investimeve, të kredive ose të investimeve që tejkalojnë një shumë të caktuar ose format e angazhimeve me rrezikshmëri, kontrollin e maturimit të aktivave dhe pasivave dhe zërave jashtë bilancit, apo pozicionin e hapur valutor, këmbimin, obsionet ose pozitat e ngjashme dhe mundësinë e hyrjes në sistemin e pagesave.

43.2 Bankat që angazhohen në aktivitete të ngjashme dhe që janë në gjendje të krahasueshme financiare duhet gjithashtu t'u përmbahen këtyre rregullave dhe urdhresave.

Neni 44

DORËZIMI I INFORMACIONIT NË BPK

44.1 Bankat duhet t'i japin BPK-së informacion lidhur me aktivitetin dhe gjendjen financiare të tyre sipas kërkesës së BPK-së.

44.2 BPK-ja mund t'i botojë këto informacione dhe të dhëna plotësisht ose pjesërisht në formë të përmbledhur për llojet e bankave të ndara sipas natyrës së aktivitetit të tyre.

RREGULLIMI DHE FUNKSIONIMI I KËMBIMIT VALUTOR

Neni 45

TREGTARËT E KËMBIMIT VALUTOR

BPK-ja është e autorizuar:

- (a) Të nxjerrë rregulla dhe urdhëresa për administrimin e transaksioneve të këmbimit valutor për individë, ndërmarrje jofinanciare, institucione financiare, për agjenci dhe instrumente të administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë;
- (b) Të mbikëqyrë dhe rregullojë tregtarët e këmbimit valutor, duke përfshirë këtu edhe bankat;
- (c) Të përcaktojë kufijtë e pozicioneve të këmbimit të valutave për tregtarët e këmbimit valutor, duke përfshirë këtu edhe bankat dhe
- (d) Të përcaktojë metodën për caktimin e vlerës së valutave ndaj valutave të tjera.

Neni 46

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË KËMBIMIT VALUTOR

BPK-ja mund të kërkojë nga tregtarët e licencuar të këmbimit valutor, duke përfshirë këtu edhe bankat, të raportojnë periodikisht për veprimtarinë e tyre, duke përfshirë pozicionet e tyre të hapura valutore për çdo valutë; BPK-ja përcakton formularët për raportim dhe dokumentet e tjera përcjellëse që duhet të dorëzohen.

Neni 47

VEPRIMET NË KËMBIMIN VALUTOR

BPK-ja mund:

- (a) Të blejë, të shesë ose të veprojë me monedha a shufra ari apo me metale të tjera të çmueshme;
- (b) Të blejë, të shesë valutë ose të veprojë në këmbimin valutor, duke përdorur për këto qëllime aktivet e përshkruara në nenin 48 dhe
- (c) Të përcaktojë kursin e blerjes, të shitjes apo të veprimit me valutat e huaja.

Neni 48

AKTIVET NË KËMBIMIN VALUTOR

48.1 BPK-ja mban në bilancin e saj dhe administron aktivat në valutë të huaj që përbëhen nga një ose nga të gjithë aktivat e mëposhtme:

- (a) Ari;
- (b) Valuta e huaj në formën e bankënotave dhe monedhave që mbahet në Kosovë apo në llogaritë bankare të mbajtura jashtë vendit në valutë të huaj në banka pasivet afatshkurtra të të cilave klasifikohen në një nga të dy kategoritë më të larta të agjencive të klasifikimit të kredive të njohura ndërkombëtarisht dhe
- (c) Letrat me vlerë të lëshuara apo të garantuara nga shtetet ose bankat qendrore të Bashkimit Europian me afat maturimi 180 ditë, të cilat përcaktohen dhe paguhen me euro.

48.2 Synimet kryesore në zgjedhjen e aktiveve në valutë të huaj janë siguria e kapitalit dhe likuiditeti. Në vaërsi të këtyre synimeve, këto aktive zgjidhen për t'i rritur fitimet.

Neni 49

MARREVESHJET E KLIRINGUT DHE TE PAGESAVE

BPK-ja për llogari të vetën ose për llogari dhe me urdhër të Organit Qendror Fiskal mund të hyjë në marrëveshje kliringu dhe të pagesave ose në një kontratë tjetër për të njëjtin qëllim me institucione qendrore të kliringut publik dhe privat jashtë vendit.

MADMINISTRIMI ME VALUTA

Neni 50

RUAJTJA E VALUTAVE

BPK-ja u jep institucioneve financiare dhe publikut, kundrejt pagesës së një tarife të arsyeshme, objekte për ruajtjen e bankënotave dhe monedhave në valutat e përcaktuara.

Neni 51

REZERVAT NË VALUTË

BPK-ja administron një rezervë në valutën që ajo e gzykon të përshtatshme për pagesat e transaksioneve të brendshme dhe ndërkombëtare për të siguruar furnizim të rregullt me valutë për përmbushjen e nevojave të ekonomisë së Kosovës dhe mund të caktojë dhe marrë tarifa të arsyeshëm për shërbime të tilla.

BILANCI FINANCIAR, KONTROLLI FINANCIAR DHE RAPORTET

Neni 52

VITI FINANCIAR I BPK-së

Viti financiar i BPK-së fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor.

Neni 53

PRAKTIKAT E KONTABILITETIT

53.1 BPK-ja mban llogaritë dhe regjistrimet për veprimet dhe gjendjen financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

53.2 Bilanci dhe deklaratat e tjera financiare të BPK-së përfshijnë llogarit e veçanta të Rezervës së përgjithshme; rezervat për mbulimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta dhe amortizimin e aktiveve.

Neni 54

BILANCI DHE DEKLARATA TË TJERA FINANCIARE

BPK-ja përgatit bilancin dhe deklarata të tjera financiare për çdo vit financiar. Ato përfshijnë bilancin, deklaratën e fitimit dhe të humbjeve dhe deklaratat e lidhura me to.

Neni 55

KONTROLLI I PAVARUR I LLOGARIVE FINANCIAR TË BPK-së

Llogaritë, regjistrimet, dhe deklaratat financiare të BPK-së kontrollohen nga ekspertë kontabël të pavarur të njohur në shkallë ndërkombëtare të rekomanduar nga Bordi drejtues dhe të miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, për shkaqe të forta, mund të shkarkojë ekspertët kontabël të pavarur të BPK-së.

Neni 56

PËRCJELLJA DHE BOTIMI I DEKLARATAVE E I RAPORTEVE

BPK-ja, brenda katër muajve pas mbylljes së çdo viti të tij financiar, i dorëzon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm:

- (a) Deklaratat financiare të vërtetuara nga ekspertët e jashtëm kontabël;
- (b) Raportin për veprimtarinë dhe punët gjatë atij viti dhe
- (c) Raportin për gjendjen ekonomike.

56.2 BPK-ja përgatit sa më shpejt që të jetë e mundur pas ditës së fundit të punës së çdo tremujori, por në çdo rast brenda 15 ditë pune, një përmbledhje të deklaratave financiare të tremujorit të fundit.

56.3 Me plotësimin e tyre, BPK-ja duhet të botojë deklaratat dhe raportet financiare të përshkruara në paragrafët 56.1 dhe 56.2; BPK-ja, nëse e sheh të arsyeshme, mund të botojë edhe raporte dhe studime të tjera për çeshtje financiare dhe ekonomike.

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 57

KONSULTIME RRETH PROPOZIMEVE RREGULLATORE

Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë konsulton BPK-në për çdo propozim lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me objektivat e BPK-së ose që janë në kompetencë të saj para se propozimet të marrin formë të prerë.

Neni 58

E DREJTA E PËRPARËSISË E BPK-së

58.1 BPK-ja gëzon të drejtën e përparësisë së pakushtëzuar për përmbushjen e gjithë pretendimeve të saj nga çdo llogari në kesh dhe aktive të tjera që ajo mban për llogarinë e saj apo për llogarinë e huamarrësit në fjalë, qoftë si kolateral për të siguruar pretendimet e veta ose, përndryshe, në kohën kur ky pretendim maturohet dhe bëhet i pagueshëm.

58.2 BPK-ja mund të ushtrojë të drejtën e përparësisë vetëm duke mbajtur llogari në para dhe duke shitur aktivat e tjera me një çmim të arsyeshëm dhe duke paguar veten nga të ardhurat nga shitja pas zbritjes së shpenzimeve të shitjes. Asnjë veprim gjyqësor nuk mund të kërkohet dhe asnjë pretendim konkurrues nuk lejohet të vonojë ushtrimin nga BPK-ja të të drejtës së saj për përparësi në përputhje me dispozitat e këtij neni, edhe as kërkesat e pronësisë ose të drejtat e fituara më parë, përderisa të mos ketë prova të qarta dhe bindëse se punonjësit e BPK-së e kanë ditur apo konsiderohet se duhej ta dinin në kohën e vënies së aktivave në pronësi të BPK-së, që ato nuk i përkisnin huamarrësit në fjalë.

Neni 59

VEPRIMTARITË E NDALUARA PËR BPK-në

59.1 Përveç rasteve kur specifikisht autorizohet ndryshe nga kjo rregullore ose ndonjë rregullore tjetër ose ndonjë direktivë administrative, BPK-ja:

- (a) Nuk jep kredi, nuk mban depozita dhe nuk jep dhurata në para apo dhurata financiare;
- (b) Nuk angazhohet në tregtim, blerje të aksioneve të ndonjë korporate apo kompanie, duke përfshirë edhe aksionet e ndonjë institucioni financiar, ose të ketë interes të pronësisë në sipërmarrje financiare, tregtare, bujqësore, industriale e të tjera dhe
- (c) Nuk fiton nga blerja, qiraja apo e drejta në pasuri të patundshme, përveç kur ajo e sheh të nevojshme a të dobishme sigurimin e lokaleve për udhëheqjen e punëve administrative apo për strehimin e punonjësve të saj ose për kërkesa të tjera të ngjashme dytësore për kryerjen e funksioneve të saj sipas dispozitave të rregullorës në fuqi

59.2 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kësaj rregulloreje, BPK-ja mund:

- (a) Të japë hua, të posedojë aksione ose të jetë pjesëmarrëse e ndonjë organizate që është e angazhuar në aktivitete që kërkohen për kryerjen si duhet të funksioneve ose përgjegjësive të BPK-së;
- (b) Të përfitojë, për shlyerjen e borxheve ndaj saj, çfarëdo interesi ose të drejta të përmendura në nenin 59.1(b) me kusht që gjithë këto interesa ose të drejta të përfituara në këtë mënyrë të jepen me rastin më të parë të mundshëm ose
- (c) Të japë kredi për punonjësit e vet për këto qëllime, në shuma, afate dhe kushte të përcaktuara prej saj me kusht që shumat e këtyre kredive të hiqen nga llogaritë kapitale.

Neni 60

GRUMBULLIMI I INFORMACIONIT STATISTIKOR

60.1 BPK-ja grumbullon informacionin e nevojshëm statistikor për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të saj dhe për këtë qëllim mund të angazhohet në bashkëpunim teknik me autoritetet kompetente jashtë Kosovës.

60.2 BPK-ja përcakton informacionin e nevojshëm statistikor dhe mënyrën sipas të cilës ky informacion i dërgohet BPK-së, personat që duhet të sjellin këtë informacion në BPK dhe procedurat për ruajtjen e konfidencialitetit që zbatohen për informacionin statistikor të dhënë BPK-së.

60.3 BPK-ja kontribuon në harmonizimin e rregullave dhe praktikave për administrimin e mbledhjes, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor brenda kuadrit të kompetencave të saj.

Neni 61

PËRJASHTIMI I BPK-së NGA TATIMET

BPK-ja, aktivet, prona dhe të ardhurat e saj, operacionet dhe transaksionet e saj, përjashtohen nga gjithë tatimet dhe detyrimet mbi të ardhurat, pasuritë, akcizat dhe tatimi mbi fitimin.

Neni 62

KOMPETENCAT RREGULLATORE DHE TË INSPEKTIMIT TË BPK-së

62.1 BPK-ja ka kompetenca të nxjerrë rregulla, urdhresa ose udhëzime, të vizitojë bankat, të kontrollojë llogaritë, librat, dokumentet dhe regjistrimet tjera, të ndërmarrë veprime të tilla të cilat i gjykon të nevojshme ose të këshillueshme për të zbatuar dispozitat e kësaj rregulloreje.

62.2 Të gjitha rregullat, urdhresat dhe udhëzimet e nxjerrë nga BPK-ja të cilat janë të zbatueshme për më shumë se një institucion, duhet të botohen dhe hyjnë në fuqi në datën e botimit ose në një datë të mëvonshme që mund të përcaktohet në vetë direktivën, urdhresën ose udhëzimin. BPK-ja mban një regjistër publik për këto rregulla, direktiva dhe udhëzime.

62.3 Rregullat dhe urdhresat e BPK-së janë vendime përfundimtare në procedurat administrative.

Neni 63

STANDARDET E ADMINISTRIMIT TË MIRË

63.1 BPK-ja në përputhje me praktikat e shëndosha administrative zbaton kompetencat e saj në mënyrë të barabartë dhe uniforme. Ajo duhet të mos i përdorë këto kompetenca në shërbim të ndonjë objekti që është jashtë këtyre kompetencave të dhëna ose që tejkalon atë që kërkohet për arritjen e objektivit për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

63.2 Vendimet e BPK-së të marra në përputhje me këtë rregullore duhet të jenë të paanshme dhe të motivuara vetëm nga konsiderata objektive dhe racionale; këto vendime ekzekutohen me ndershmëri dhe maturi.

Neni 64

LLOGARITË TRUST

BPK-ja autorizohet të hapë dhe mbajë në librat e veta, llogaritë, aktivet dhe pasivet e të cilave duhen veçuar nga aktivet dhe pasivet e tjera të BPK-së. Aktivet e çdo llogarie të tillë vëvhen në dispozicion vetëm për plotësimin e pasiveve të asaj llogarie dhe asnjë aktiv tjetër i BPK-së nuk vëhet në dispozicion për të plotësuar pasivet e kësaj llogarie.

Neni 65

PRAKTIKA E PUNËSIMIT

BPK-ja zbaton politikë jodiskriminuese të punësimit në mënyrë që përbërja e stafit të pasqyrojë natyrën shumetnike të bashkësisë në Kosovë.

Neni 66

SHQYRTIMET GJYQËSORE

Në çfarëdo procedure gjyqësore apo të arbitrazhit që ngritet lidhur me këtë rregullore kundër BPK-së ose ndonjë zyrtari, nëpunësi a agjenti të BPK-së:

- (a) E vetmja pyetje para gjyqit ose gjyqit të arbitrazhit në përcaktimin se a ka vepruar i pandehuri kundër ligjit, është nëse i pandehuri ka vepruar në mënyrë arbitrare apo kapriçioze duke ditur faktet dhe ligjin ose rregullat, urdhresat dhe udhëzimet e nxjerra;
- (b) Një administrator, punonjës apo agjent i BPK-së nuk mund të jetë përgjegjës për dëmet, veprimet ose mosveprimet e bëra gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiive të tij, përveç kur këto veprime ose mosveprime përbëjnë qëndrim të gabuar me dashje dhe
- (c) Veprimi në fjalë do të vazhdojë pa kufizime gjatë periudhës së një ankimi dhe çdo ankimi të mëtejshëm apo procedurave të tjera gjyqësore lidhur me ankimin.

Neni 67

INTERPRETIMI

67.1 Titujt në këtë rregullore janë përdorur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk janë pjesë apo nuk kanë synim të drejtojnë, kufizojnë ose ndihmojnë në kuptimin e ndonjë termi ose dispozite të kësaj rregulloreje.

67.2 Termat e përdorur në lidhje me njëri-tjetrin ose jo në lidhje me njëri-tjetrin në këtë rregullore mund të lexohen edhe anasjelltas sa herë që ndryshimi është i nevojshëm për të qartësuar kuptimin e dispozitës në fjalë.

67.3 Fjalët e përdorura në njëjës në këtë rregullore mund të lexohen edhe në shumës dhe anasjelltas sa herë që ndryshimi është i nevojshëm për të qartësuar kuptimin e dispozitës në fjalë.

Neni 68

ZBATIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka kompetencë të nxjerrë direktiva dhe urdhra administrativë për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 69

EFEKTE MBI DISPOZITAT LIGJORE TË MËPARSHME

Dispozitat e legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me çeshtjet e përfshira në këtë rregullore zbatohen në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 70

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi më 15 nëntor 1999.

Neni 71

DISPOZITA KALIMTARE

71.1 Pavarësisht nga nenet 11 dhe 12, deri në dy vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje ose në një datë më të hershme kur BPK-ja mund të vendosë që bankat në Kosovë janë të pajisura për të kryer këto shërbime, BPK mund të hapë llogari rrjedhëse në librat e saj në emër të personave fizikë dhe të ndërmarrjeve në valutat e përcaktuara prej saj, me ose pa tender ligjor, të marrë dhe të shpërndaj para e të mbajë llogari për to dhe të kryejë shërbime pagesash e arkëtimi lidhur me to. BPK-ja paguan në kufijtë e shumës së gjendjes së llogarisë rrjedhëse kundrejt urdhër pagesave lidhur me këto llogari. BPK-ja nuk paguan interes për këto deponime. Këto llogari janë subjekt i kriterëve dhe kushteve të mëtejshme të cilat do t'i caktohet BPK-ja, duke përfshirë pagesën e tarifave të arsyeshme. Këto llogari rrjedhëse nuk merren parasysh për përcaktimin e shumës së kapitalit dhe të llogarive të Rezervës së përgjithshme në lidhje me shumat e bilancit të kredisë të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e BPK-së nga mbajtësit e llogarisë të treguara në bilancin e BPK-së në fund të çdo viti financiar.

71.2 Tridhjetë ditë pas ditës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, asnjë entitet nuk mund të kryejë veprimtari bankare në Kosovë pa paraqitur një kërkesë BPK-së për të marrë licencë për kryerjen e aktivitetit të një banke në përputhje me këtë rregullore.

71.3 Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, organet që kryejnë transaksionet e pagesave dhe veprimtaritë e bankës qendrore në Kosovë duhet të ndërpresin aktivitetin e tyre nëse, sipas mendimit të BPK-së, ndërhyjnë në kryerjen e funksioneve të BPK-së.

71.4 Shpërblimi i marrë nga anëtarët e Bordit drejtues për shërbimin e tyre në BPK ose heqja dorë nga ky shpërblim, veç asaj që përcaktohet në nenin 19, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm duhet të njoftohet me shkrim.

Bernard Kouchner,

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm